

FJALA E DEPUTETES ALBANA VOKSHI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar qytetarë,

Dua ta nis fjalën time me një ndjesë për qytetarët, sepse edhe dje, në vend që të trajtonim hallet e problemet tuaja, ne u morëm me hallet tona, duke i lënë fushë të lirë këtij Kryeministri që këqyr i kënaqur përtej gardhit të pushtetit, të cilin vazhdon e ndan me klientë e oligarkë. Dje nuk bëmë gjë tjetër veçse prodhuam për orë të tëra debate, herë të sajuara, herë të sforcuara dhe herë të planifikuara, furnizuam këdo me këto debate politike që mbushin kohën, mbase edhe mendjen për pak çaste, por nuk mbushin dot barkun bosh të qindra-mijë fëmijëve, prindërit e të cilëve gdhihen e ngrysen në mjerim, për më tepër me më shumë borxhe, edhe më të rritura nga ky buxhet që po diskutojmë sot edhe për breza të tjerë.

Të dashur qytetarë,

Sot ne vazhdojmë të diskutojmë buxhetin e një qeverie pa asnjë kredo morale kundrejt qytetarëve, të cilëve ua blen votën e më pas i braktis për 4 vjet. Ndërkohë që Kryeministri dje rreshtonte arritjet “spektakolare” të qeverisë së tij, më vinin ndër mend diskutimet me orë të gjata në seancat dëgjimore me përfaqësuesit e shoqatave të të sëmurëve me diabet, talasemi, të personave me aftësi të kufizuar, të të verbërve, sindikatave të pacientëve, shoqatave të shëndetit, të grave e fëmijëve e të tjera. Të gjithë të lodhur e të sëmurë, të nëpërkëmbur, të injoruar, të revoltuar, sepse prej vitesh asgjë nuk ndryshon për ta, askush nuk i dëgjon, askush nuk i shikon, askush as nuk denjon t’u përgjigjet kërkesave të tyre zyrtare. Këta qytetarë kërkojnë vetëm të drejtat e tyre ligjore e kushtetuese, të cilat iu shkelen çdo ditë; kërkojnë përkujdesje e përkushtim nga shteti, si në çdo shtet tjetër. Kryeministri dhe ministrja nuk kanë as sy dhe as vesh për ta.

E ftoj Kryeministrin dhe ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies që të ulen, të marrin pak kohë nga koha e tyre e ta dëgjojnë atë seancë dëgjimore, e cila është në Facebook, për të kuptuar sa larg realitetit është ky buxhet që ju na sillni sot, sepse nuk akomodon as edhe një problem apo shqetësim të tyre. “Buxhet historik”-, tha ministrja e Shëndetësisë në seancë dhe në komision, ndërkohë që edhe ky buxhet, ky historiku, është i fundit në rajon, pra më i ulëti në rajon, e pranuar edhe nga ministrja e Financave. Pra, shëndetësia nuk është prioritet për këtë qeveri. Po ku shkojnë paratë e këtij buxheti për shëndetësinë? Kryeministri dje na bëri një ekspozë, por ai nuk foli për qytetarët, por mbrojti me pasion, si çdo herë, koncesionet e koncesionarët, klientët e përsëri oligarkët sponsor të fushatave të tij elektorale. E mbani mend kur Edi Rama premtoi “shëndetësi falas”? Sot ai nuk flet më për të. Shqiptarët sot paguajnë 58% të shpenzimeve të tyre shëndetësore nga xhepi, që janë më të lartat në rajon. Serbia e ka 41%, Maqedonia e Veriu 35%, Bosnja Hercegovina 29% dhe mesatarja e BE-së është 15%. Edi Rama premtoi shëndetësi falas, por shpenzimet për frymë në shëndetësi janë më të ulëtat në rajon me 116 euro, ndërkohë që Maqedonia e Veriut i ka 187 euro, Serbia 248 euro dhe Bosnje Hercegovina 268 euro. Edi Rama premtoi shëndetësi falas, por sot shqiptarët për të bërë një “PET skaner” duhet të shkojnë në Maqedoni, Greqi ose Itali. Edi Rama premtoi shëndetësi falas, por sot shqiptarët duhet të kurohen në spitale private për sëmundje pak më të vështira, madje edhe kur ato

paguhen nga paketat shtetërore. Edi Rama premtoi shëndetësi falas, por sot, bazuar dhe në një raport të Eurostatit, 380 mijë shqiptarë nuk përballojnë dot shpenzimet e kurat mjekësore. Ashtu siç e pranoi edhe ministrja e Shëndetësisë në komision, nga më shumë se 190 mijë qytetarë të prekur me Covid, të cilët janë të regjistruar zyrtarisht, janë rimbursuar rreth 7500, të tjerët janë në mëshirë të fatit. Nga rreth 1000 dollarë që kushton mesatarisht një paketë kurimi për Covid, janë rimbursuar vetëm 40 dollarë, ndërsa 960 dollarë janë paguar nga xhepi i qytetarëve.

Siç raporton INSTAT-i, në anketën e buxhetit të familjeve për shpenzimet e shëndetit, buxheti për këtë shpenzim është rritur me 28% vitin e kaluar dhe këto para kanë dalë nga xhepi i qytetarëve. Përfituesit e vetëm të shëndetësisë së Ramës janë koncesionarët. Kostoja e shërbimeve që ofrojnë koncesionarët është disa herë më e lartë se kur këto shërbime ofroheshin nga shteti. Shihni abuzimin me koncesionin e check up-it, ku janë rreth 8,8 milionë euro abuzim për shërbime të paofruara asnjëherë -, thuhet nga KLSH-ja. Abuzimi me sterilizimin, ky shërbim në shtet kushtonte 2,4 euro, ndërsa qeveria i paguan koncesionarit më shumë se 200 euro. 400 milionë euro ka parashikuar qeveria, por mund të shkojë edhe më shumë se kaq, për 4 koncesione. Me paratë që u janë dhënë deri më tani këtyre koncesioneve të panevojshme dhe abuzive mund të ishin ndërtuar 2 superspitale, që mund të kishin siguruar jo vetëm decentralizim të shërbimit shëndetësor dhe uljen e fluksit të QSUT-së, por edhe mund të sigurohej shërbim publik falas për qytetarët. Kur njerëzit harxhojnë dhjetëra e mijëra lekë për teste dhe analiza për Covid-in, Rama i jep para për teste apo shërbim të pakryer koncesionarit të check up-it. Pra, kjo është një vjedhje e pastër e parave të publikut dhe shpërdorim skandaloz i parave që duhet të shkonin për shëndetësinë në një moment krize për të forcuar sektorin publik. E pyeta shumë herë ministren të na informonte për numrin e mjekëve të larguar këto vite, por refuzoi ta bënte. Pse? Sepse mjekët po ikin çdo ditë. Ikin për të mos u kthyer më; ikin më të mirët e më të talentuarit, të cilët ne braktisim dhe i përbuzim, ndërkohë që Gjermania e vende të tjera i mirëpresin, i respektojnë, i punësojnë dhe i trajtojnë me dinjitetin që u takon. As buxheti 2022 nuk parashikon asnjë trajtim ndryshe për mjekët, të cilët nuk u vlerësuan, respektuan, përkundrazi u denigruan dhe u braktisën, edhe në betejën e tyre përballë virusit Covid-19. Buxheti i 2022 ka zero politika për të mbajtur mjekët dhe infermierët. Buxheti i 2022 është një dokument jo vetëm i hartuar mbrapsht për nga logjika ekonomike, por pikësëpari një projekt që do të thellojë edhe më shumë varfërinë dhe do të sjellë edhe më shumë pesimizëm te shqiptarët. Ai nuk akomodon asnjë problematikë të evidentuar nga raportet e Komisionit European, Bankës Botërore, KLSH-së, prandaj vota e Partisë Demokratike është kundër. Ky është buxheti i oligarkëve të koncesioneve, të cilët prej vitesh kanë gjuhëzuar shtetin në funksion të pushtetit pa limit të oborrit ekzekutiv të Ramës, ndërkohë që listat e familjeve në varfëri të plotë shtohet nga dita në ditë.

Fundi i vitit po afron dhe po kështu edhe festat. Për ju do të ketë festë, jam e sigurt, por për shumicën e shqiptarëve nuk do të ketë, sepse tryezat do të jenë më të varfra e të zbrazëta se kurrë. Ky është ndër vitet më të ligshhta në historinë e tranzicionit të gjatë shqiptarë. Kemi një problem të madh me këtë qeveri, sepse mashtrojnë e nuk japin as llogari, sepse vjedhin zgjedhjet e më pas nuk japin as llogari, prandaj vijnë me këtë buxhet. Për sa kohë Edi Rama do të jetë në krye të kësaj qeverie, do të kemi buxhete të tilla. Ju, të dashur qytetarë, do të jeni të pasigurt, të përjashtuar nga përfitimet e ligjshme që ju takojnë prej sistemit. Shëndetësia do të jetë vetëm për pak njerëz që kanë mundësi të paguajnë. Për sa kohë Edi Rama do të jetë në krye të kësaj qeverie, me taksat tuaja, ju të dashur qytetarë, do të vazhdoni të paguani shtrenjtë korrupsionin dhe klientelizmin e kësaj qeverie të kapur nga interesa të pista personale. Për sa kohë Edi Rama do të jetë në krye të kësaj qeverie, ai do të vazhdojë t'ju tallë, t'ju nëpërkëmbë, t'ju rrezikojë shëndetin tuaj dhe të njerëzve të dashur. Për sa kohë ky njeri do të jetë Kryeministër, nuk do t'ju lërë kohë as të ankoheni, sepse ai e blen pushtetin. Është sfida më e madhe politike dhe morale e një Partie Demokratike më të fortë e më të bashkuar

dhe e shoqërisë që të bëhemi bashkë për të nisur shërimin. Ky është ilaçi që na duhet për të shpëtuar nga e keqja! Ndaj vota e Partisë Demokratike shkon kundër këtij buxheti.